



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
KËSHILLI I MINISTRAVE  
KËSHILLI KOMBËTAR I TERRITORIT

V E N D I M

Nr. 8, Datë 05.05.2015

PËR

MIRATIMIN E RISHIKIMIT TË KUSHTEVE DHE SHTYRJEN E AFATIT TË LEJES SË NDËRTIMIT PËR PROJEKTIN "TIRANA BUSINESS PARK", NË FSHATIN FUSHË – PREZË, MIRATUAR ME VENDIM NR. 1, DATË 21.03.2011 TË KRRTRSH "NDRYSHIMI I LEJES SË SHESHIT DHE INVESTITORIT PËR OBJEKTIN "TIRANA BUSINESS PARK" ME SIPËRFAQE SHESHI 210 566 M<sup>2</sup> DHE SIPËRFAQE NDËRTIMI 89 203 M<sup>2</sup>"

Në mbështetje të neneve 27, 28, 40 dhe 48 të Ligjit nr. 107/2014, datë 31.07.2014 "Për Planifikimin dhe Zhvillimin e Territorit", Vendimit nr. 877, datë 03.10.2013 të Këshillit të Ministrave "Për përbërjen e Këshillit Kombëtar të Territorit", me propozimin e Ministrisë së Zhvillimit Ekonomik, Turizmit, Tregtisë dhe Sipërmarrjes, Këshilli Kombëtar i Territorit.

VENDOSI:

1. Miratohet kërkesa e subjektit zhvillues "Tirana Business Park" sh.p.k, për rishikimin e kushteve dhe shtyrjen e afatit të Lejes së Ndërtimit për projektin "Tirana Business Park", në fshatin Fushë – Prezë, miratuar me Vendim nr. 1, datë 21.03.2011 të KRRTRSH "Ndryshimi i Lejes së Sheshit dhe investitorit për objektin "Tirana Business Park" me sipërfaqe sheshi 210 566 m<sup>2</sup> dhe sipërfaqe ndërtimi 89 203 m<sup>2</sup>".
2. Bashkëlidhet si pjesë përbërëse e këtij vendimi Harta e Planvendosjes së Strukturave ku reflektohen ndryshimet e kushteve të lejes.
3. Miratohet zgjatja e afatit të Lejes së Ndërtimit deri në datën 31.12.2017.
4. Ngarkohet Ministria e Zhvillimit Ekonomik, Turizmit, Tregtisë dhe Sipërmarrjes për lëshimin e Formularit të Lejes së Ndërtimit.
5. Ngarkohet Ministria e Zhvillimit Ekonomik, Turizmit, Tregtisë dhe Sipërmarrjes dhe Komuna Prezë për zbatimin e këtij vendimi.
6. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETAR

EDI RAMA



**ZËVENDËS KRYETARE E KKT**

**EGLANTINA GJERMENI**

**MINISTËR I ZHVILLIMIT URBAN**



**Z. ARBEN AHMETAJ**

**MINISTËR I ZHVILLIMIT EKONOMIK, TURIZMIT, TREGTISË DHE SIPËRMARRJES**



**SEKRETARE E KKT**

**ADELINA GRECA**

*Handwritten signature in blue ink.*

**DREJTORE E AGJENCISË KOMBËTARE TË PLANIFIKIMIT TË TERRITORIT**